



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19.4.2023

Nr: 378

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT, TË SUBJEKTIT VETËDEKLARUES
Z. ELIS SIMON DOÇI, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK, I PROPOZUAR NGA
SUBJEKTI ZGJEDHOR KOALICIONI "BASHKË FITOJMË", PËR BASHKINË SHKODËR**

Sot më datë 19.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

OBJEKT: Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Elis Simon Doçi, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojmë", për Bashkinë Shkodër.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për

Data: 19.4.2023 Nr: 378
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Elis Simon Doçi, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojmë", për Bashkinë Shkodër".

funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KQZ-së, z. Elis Simon Doçi, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për Bashkinë Shkodër.

Për këtë kandidat, në datën 28.3.2023, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me nr. unik SHK-BF-5606. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Në përgjigje të kësaj kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve informon se kandidati në fjalë nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Elis Simon Doçi, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjeneralitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar se ka ndryshim tek gjeneralitetet e tij.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, Prokuroria e Italisë, ka kërkuar në vitin 2017, masë sigurimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo gjykatë ka dhënë vendim pafajësie për subjektin në fjalë dhe lirim të menjëhershëm të tij.
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO, Prokuroria e Italisë ka kërkuar në vitin 2017, masë sigurimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo gjykatë ka dhënë vendim pafajësie për subjektin në fjalë dhe lirim të menjëhershëm të tij.
- Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”, arrest shtëpie, por është revokuar.
- Pyetjes 6 “A është lëshuar ndonjëherë ndaj personit tuaj një urdher kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e një vepre penale?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka pasur indicie nga Prokuroria e Italisë, për ekstradimin e subjektit të lartpërmendur, por nuk është në fuqi, pasi ndaj subjektit të lartpërmendur ka vendim pafajësie.
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë

se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, nga viti 2009, ka jetuar në Itali, për arsye emigracioni.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë, në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për veprat penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Në mbështetje të nenit 8, pika 1, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii)”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z.Elis Simon Doçi, kandidat për anëtar në Këshillin Bashkiak, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për Bashkinë Shkodër, dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI